



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
ZYRA ARSIMORE LUSHNJE

ZGJIDHJA - TESTI I OLIMPIADËS KOMBËTARE TË GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË
FAZA E I KLASA E X

Çelësi i olimpiadës, klasa 10. Gjuhë shqipe dhe letërsi.

1-Parafrazo...

(...Mjegulla e dendur kishte zbritur mbi lumin e Bunës dhe shpërhapej në të gjithë fushën e Shkodrës. Një erë e mprehtë fryu dhe e lartoi mjegullën mbi muret e kalasë, ku punonin tre vëllezër. Punonin gjithë ditën, por muri që ndërtonin u rrëzohej natën. Bashkë me mjegullën, kaloi aty pranë një plak i urtë. Iu uroi tre vëllezërve punë të mbarë. Të mbarë paç, o plak i mirë, i ishin përgjigjur vëllezërit. Ata i rrëfyer plakut se asgjë s'po iu shkonte mbarë. Ditën punonin, ngrinin muret e kështjellës, ndërsa natën muret rrëzoheshin. Si me përvojë që ishte, plaku i urtë mund t'ju jepte ndonjë këshillë...)

Për të bërë vlerësimin e parafrazimit, duhen pasur parasysh elementet e mëposhtëm.

1-Ndarja e tekstit në njësi sintaksore sipas shenjave të pikësimit; vendosja e e pikësimit.(2 pikë.)

2-Organizimi në rend të drejtë i fjalive, duke shmangur fjalitë eliptike, zëvendësimi i fjalëve dhe shprehjeve të vështira me sinonime.(2 pikë.)

3-Ruajtja e mundshme e figuracionit letrar.(2 pikë.)

4-Zëvendësimi i ligjeratës së drejtë me ligjeratën e zhdrejtë.(2 pikë.)

5-Ruajtja e koherencës dhe mungesa e komenteve subjektive për tekstin.(2 pikë.)

2-Shpjego:

a)-Baladë.(it,ballare=vallëzoi).Krijim liriko-epik me subjekt; me nota të dhimbshme elegjiake që flet për fatkeqësitë e heroit.Krahas elementeve reale shfaqen edhe elemente të jashtëzakonshme.

b)-Murimi. Te murimi ose murosja qëndron zakoni i flijimit të një njeriu në themel të ndërtimeve që, në këngët legjendare, është më së shumti një kështjellë, një urë, një kishë apo manastir. Ajo që flijohej ishte një grua, si simbol i jetës, i pjellshmërisë, pra bartëse e forcës së jetës. Njeriu primitiv mendonte se duke sakrifikuar jetën e një njeriu, ajo jetë që i merrej atij kalonte në qëndrueshmërinë e godinës.

c)...nji shenjt i gjallë...- Kemi figurën e metonimisë.Koncepti i urtësisë njerëzore shfaqet si shenjë e ardhur që nga mitikja.


d)...fryni erë, frashni e hollë,/ -Figura e metaforës që paralajmëron lartësimin e mjegullës në kodër, paralel me mjegullën që shoqëron mendimet e tre vëllezërve.

3-Përcakto:

a)llojin.Tekst poetik, liriko-epik.Funksioni,estetik.Tema e mbijetesës së një kombi nëpërmjet sakrificave vetmohuese.

4-Skema e komunikimit.

Mesazhi- Qëndresa jonë nëpër shekuj ka kërkuar gjithmonë sakrifica,është e mbrujtur me gjakun dhe jetën e të gjithë shqiptarëve.



5- Shembull:1-

Aj ma i madhi zanë vëlla/Prishi besë ,e prishi fe/Në konak-ë e bjesedoj-ë/vashës ti-ë i kalxojë.2-Lepe nanë, e brraf në kamë...

Përsëritjet e mësipërme quhen përsëritje epike. Shpesh herë rapsodët përsëritin vargje në pjesë të ndryshme.Një përsëritje e tillë lidh më mirë pjesët e rrëfimit, rimerr detajin për të cilin bëhet fjalë dhe përforcon idenë që do të theksohet.Kështu, vargjet e shembullit 1 theksojnë se zakoni i lashtë i murosjes nuk miratohet as nga këngëtari i vjetër popullor, as nga dy vëllezërit.

Shembulli 2.Thekson zakonin e përulësisë së nuseve përpara nënës gjelinë nga njëra anë (matriarkati), dhe të bën të mendosh se kur është kënduar kënga, vëllezërit janë kundër zakonit të murosjes, edhe pse nusja e vogël e ndien veten si viktimë dhe nuk shkon me qejfin e një njeriu që do të plotësonte një zakon të pranuar më parë.

Përgjigjja për pjesën e parë të pyetjes së parë,ku shpjegon funksionin në përgjithësi të letërsisë

6.- Në natyrën e saj letërsia, si art i fjalës, ka funksion estetik, kështu që trillimi dhe e bukura janë pjesë e botës së letërsisë, ku forma (si thuhet?) dhe përmbajtja (çfarë thuhet?) duken se përputhen midis tyre (forma është njëkohësisht përmbajtje dhe e anasjellta). **-4 pikë**

Përgjigja për pjesën e dytë të pyetjes së parë ku shpjegon konkretisht këtë funksion tek "Iliada,

- Konkretisht tek "Iliada", ne shohim se si lufta për Helenën na shpie te fillesat mitologjike të saj. Sipas mitit Helena iu premtua Paridit nga perëndesha e dashurisë, Afërdita, pasi ai ia kishte dhënë asaj mollën e artë në konfliktin që kishte lindur midis tre perëndeshave të Olimpikut pas mollës që perëndia e sherrit, Erida, hodhi me mbishkrimin: "Më të bukurës".

-2 pikë-

Në botën e lashtë greke historia mitologjizohet dhe jemi në kontekstin historik të krijimit të klasës së aristokracisë, e cila jepet përmes kultit të sundimitarit, Agamemnonit, në konflikt me kryeheroin, Akil Pelidin apo Akil Hyjnerin, gjysmënjeri e gjysmëperëndi. Përkundrazi e bukura zbret nga Olimpi (si të gjitha perënditë greke) dhe merr trajta njerëzore me gjithë dritë-hijet e saj. Paridi dhe Helena janë dy dashnorët e parë të letërsisë.

-2 pikë

- "E Bukura" (e personifikuar me Helenën, por që simbolizon edhe të bukurën në art) duhet fituar madje edhe me sakrificat të tilla, siç ishte lufta dhejtëvjeçare midis grekëve dhe trojanëve, ku nga njëra anë grekët kërkojnë Helenën si pjesë e nderit dhe dinjitetit të tyre, nga ana tjetër trojanët refuzojnë t'ua kthejnë duke e konsideruar si pjesë të fatit të tyre.

-2 pikë

7. Përgjigja për pjesën e parë të pyetjes së dytë

- Vargu hyrës i "Iliadës" (*Këndo, hyjneshë, mëninë e Akil Pelidit*) tregon se për poetët antikë, dhe jo vetëm, frymëzimi poetik është me natyrë hyjnore dhe poeti është i zgjedhur nga Hyjnia me misionin për të realizuar krijimin artistik.

-3 pikë

Përgjigja për pjesën e dytë të pyetjes së dytë

- Lloji letrar, ku përdoren formula të tilla hyrëse, është poema epike (specifikisht heroiko- legjendare). Një shembull të tillë të eposit homerik e pasoi eposi romak, "Eneida" e Virgjilit, eposet folklorike të vendeve të ndryshme ("Këngët e Rolandit" në Francë, "Këngët e Sidit" në Spanjë, eposi shqiptar i kreshnikëve) e deri te "Lahuta e Malcis" e Gjergj Fishtës.

-3 pikë

8. Vlersimi me dy pikë sipas katër rubrikave të esesë përshkruese.

-2 pikë për strukturën e esesë përshkruese

-2pikë për stilin dhe origjinalitetin

- 2 pikë për koherencën dhe kohezionin

-2 pikë për drejtshkrimin dhe shenjat e pikësimit